



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	28.07.2026	14.08.2026	2026/0531

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.07.2026, OE “Hajrush J. Shoshi B.I.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0531, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Mondi Shpk”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rindertimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindertimi dhe renovimi i salles se sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindertimi dhe renovimi i salles se sportit ne shkollen fillore Lidhja e Pejes LOT 3 Rindertimi dhe renovimi i strehes ne sallën e sporteve te shkolles Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindertimi dhe renovimi i shkolles SHMFU Pjeter Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit te salles se sportit ne shkollen fillore Lidhja e Pejes” me nr. të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: pun?, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: : **52.070.00** €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Nenet:1 ,

Nenet e LPP-së: Neni 7 (Trajtimi i Barabartë),

Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve),

Neni i LPP-së 28 ,

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Hajrush J. Shoshi B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RROUP): Neni 41-

Ekzaminimi,

Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve ,

5. Specifikimet Teknike

Në më datë 10.07.2026 jemi njoftuar përmes letrës standarde si operator ekonomik i pa suksesshem të ofertes

tone dhe me pas kemi kërkuar qasje në dokumentet zyrtare të operatorit ekonomik të rekomanduar për

kontrate “MONDI “ SH.P.K dhe Autoriteti Kontraktues -KOMUNA E PEJËS na ka njoftuar me datë

10.07.2026 që na mundësohet qasja në dokumente zyrtare për këtë aktivitet prokurimi dhe komplet

dokumentacioni i kërkuar na ipet në USB dhe në CD dhe gjatë qasjes në dokumente zyrtare në kemi gjetur

parregullsi gjatë vlerësimit për këtë aktivitet prokurimi dhe do të paraqesim faktet si në vijim :

Pretendimi ankimor 1.

Gjatë ekzaminimit të ofertës së “MONDI “ SH.P.K ” tek pjesa e “ formular “ kemi vërejtur se ky operator

ekonomik i përgjegjshëm nuk ka dorëzuar dokumentacionin autentik të prodhuesit-katalogun sipas

kërkesës në dosjen e tenderit, :

ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Sipas dëshmisë me lartë vërtetohet se prej Nr.1 deri tek 17 askund nuk gjendet dokumentacionin autentik të

prodhuesit-katalogun dhe me këtë rast AK-ja është dashur ta eliminojë gjatë vlerësimit OE “MONDI “

SH.P.K sipas Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për

prokurimin Publik , pika 5.

Specifikimet Teknike ,

Poashtu sipas Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik pika 10.

Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj

në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Andaj me këte rast AK-ja është dashur ta eliminoj gjatë vlerësimit OE “MONDI “ SH.P.K duke refuzuar

tenderin pa kërkuar informacion të mëtjetshëm pasi nuk ka dorëzuar fare dokumentacionin autentik të

prodhuesit-katalogun .

Pretendimi ankimor 2.

Gjatë ekzaminimit të ofertës së “MONDI “ SH.P.K ” tek pjesa e “ formular “ kemi vërejtur se ky operator

ekonomik i papërgjegjshëm nuk ka dorëzuar Deklaratat tatimore vjetore apo kopjet e raporteve financiare. sipas kërkesës në dosjen e tenderit, :

AK-ja Komuna e Pejës ka kërkuar si në vijim :

Gjatë qasjes në dokumentet zyrtare dhe ofrimit të dokumentacionit nga AK-ja Komuna e Pejës në nuk kemi pa

se OE MONDI “ SH.P.K ka ofruar Deklaratat tatimore vjetore apo kopjet e raporteve financiare

sipas kërkesës 1 në dosjen e tenderit , andaj duhet të shpallet i papërgjegjshëm pasi nuk ka përmbushur

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: kërkesën 1 të Dosjes së Tenderit .

Dëshmia 1 :

Sipas dëshmisë me lartë “formulari “ vertetohet se prej Nr.1 deri tek 17 askund nuk gjindet Deklaratat

tatimore vjetore apo kopjet e raporteve financiare . andaj duhet të shpallet i papërgjegjshëm MONDI “

SH.P.K .

Pretendimi ankimor 3.

Gjatë ekzaminimit të ofertës së MONDI “ SH.P.K .”, është vërtetuar se ky operator është i papërgjegjshëm

pasi që vertetohet tek “ formular “ se prej Nr.1 deri tek 17 askund nuk gjindet pra VENDIMI PER

PROJEKT MENAXHER pra nuk është baze të kërkesës së AK-së në DT .

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës ka kërkuar si në vijim :

Poashtu nuk është dokumentuar me trust se inxhinieri Faruk Kryeziu ka 5 vite provoja punë pas diplomimit.

Andaj me këtë rast AK-ja është dashur ta eliminojë dhe ta shpallë të papërgjegjshëm gjatë vlerësimit OE

“MONDI “ SH.P.K duke refuzuar tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm pasi nuk ka dorëzuar fare

VENDIMI PER PROJEKT MENAXHER si dhe dokumentuar me trust.

Pretendimi ankimor 4.

Gjatë ekzaminimit të ofertës së MONDI “ SH.P.K .”, është vërtetuar se ky operator është i papërgjegjshëm

pasi që vertetohet se sipas “ formular “ prej Nr.1 deri tek 17 askund nuk gjindet pra LOT1&2 ANEKSI 7

LISTA E PAJISJEVE (i obligueshem) sipas kërkesës së AK-së në DT .

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës ka kërkuar si në vijim :

8/4

Poashtu pajisjet motorike të cilat nuk i kanë paisjet e regjistruara eliminohen nga ky a.P të

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Hajrush J. Shoshi B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

eliminohet.

dhe operatori ekonomik “ MONDI “ SH.P.K ka pajisje me libreza dhe afat të skaduar që nga viti 2022,

dhe 2023.

Dëshmia 1 : Kamion kiper me kran me 2 dyer (03-724-EF) me afat të skaduar me datë 19.09.2023 :

Dëshmia 2.

Kamion me kran 2 dyer (03-921-GA) me afat të skaduar me datë 03.11.2023 :

9/4

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik , gjegjësisht RREGULLAT dhe

UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK

neni 41 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

41.1 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat

dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do të epet tenderuesit që ka renditjen më të

lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht,

kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë , kërkojmë nga Ju si AK që të

aprovoni kërkesën tonë për rishqyrtim :

VENDIM

APROVOHET ,si e bazuar ankesa e OE:

“ Hajrush J.Shoshi B.I ”

ANULOHET , B58 NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK datë 10.07.2026

OBLIGOHET, Komuna e Pejës të kthejë lëndën në RIVLERËSIM dhe gjatë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Hajrush J. Shoshi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës**” me numër të prokurimit: “**635-26-2916-5-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PEJES**

rivlerësimit të veprave sipas LPP si dhe RRUOPP .

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tenderit - FDT

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Hajrush J. Shoshi B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Pergjigja nga AK 1

Pas analizimit të të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues konstaton se asnjëri nga pretendimet nuk qëndron dhe nuk mbështetet në gjendjen faktike të dokumentacionit të tenderit.

Procedura e vlerësimit është zhvilluar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë.

Operatori Ekonomik MONDI SH.P.K. është rekomanduar për dhënie të kontratës pasi ka paraqitur ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët, duke përmbushur të gjitha kërkesat administrative, profesionale, teknike dhe financiare të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Lidhur me Pretendimin Ankimor Nr. 1

Ankuesi pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka dorëzuar katalogët e prodhuesit. Ky pretendim është plotësisht i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues konstaton se katalogët e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit janë dorëzuar fizikisht nga Operatori Ekonomik i rekomanduar, ashtu siç është kërkuar në dokumentacionin e tenderit. Gjatë procesit të vlerësimit këta katalogë janë shqyrtuar dhe është konstatuar se specifikimet teknike të ofruara janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, pretendimi se katalogët nuk janë dorëzuar nuk është i vërtetë dhe nuk paraqet bazë ligjore për eliminimin e operatorit ekonomik.

Lidhur me Pretendimin Ankimor Nr. 2

Ankuesi pretendon se Operatori Ekonomik nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore apo raportet financiare.

Edhe ky pretendim është i pabazuar.

Komisioni i Vlerësimit ka verifikuar dokumentacionin ekonomik dhe financiar dhe ka konstatuar se Operatori Ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit, duke përmbushur plotësisht kërkesat për kapacitet ekonomik dhe financiar.

Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë ligjore për shpalljen e operatorit ekonomik si të papërgjegjshëm.

Lidhur me Pretendimin Ankimor Nr. 3

Ankuesi pretendon se mungon vendimi për Projekt Menaxherin dhe dokumentimi i përvojës së tij.

Pas rishqyrtimit të dokumentacionit, Autoriteti Kontraktues konstaton se Operatori Ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për stafin profesional në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se personeli profesional i propozuar plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe se nuk ekziston asnjë mangësi që do të ndikonte në përgjegjshmërinë e ofertës.

Prandaj edhe ky pretendim refuzohet si i pabazuar.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Hajrush J. Shoshi B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Lidhur me Pretendimin Ankimor Nr. 4

Ankuesi pretendon se Operatori Ekonomik nuk ka dorëzuar listën e pajisjeve dhe se disa automjete kanë dokumente të skaduara.

Ky pretendim nuk qëndron.

Komisioni i Vlerësimit ka verifikuar dokumentacionin e pajisjeve dhe ka konstatuar se Operatori Ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar asnjë mungesë që do ta bënte ofertën të papërgjegjshme apo që do të përbënte bazë ligjore për eliminimin e operatorit ekonomik.

Për më tepër, të gjitha dokumentet e dorëzuara janë shqyrtuar gjatë procesit të vlerësimit dhe janë konsideruar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Përfundim

Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimet e paraqitura nga Operatori Ekonomik ankues nuk provojnë asnjë shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nuk dëshmojnë se gjatë procedurës së vlerësimit është vepruar në kundërshtim me Dosjen e Tenderit apo dispozitat ligjore.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Operatori Ekonomik **MONDI SH.P.K.**:

- ka dorëzuar ofertën me çmimin më të ulët;
- ka përmbushur të gjitha kërkesat administrative;
- ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike;
- ka dorëzuar katalogët fizikisht sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit;
- ka dorëzuar dokumentacionin ekonomik dhe financiar në përputhje me Dosjen e Tenderit;
- ka plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues konstaton se vendimi për rekomandimin e Operatorit Ekonomik **MONDI SH.P.K.** është marrë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, si dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Andaj, në bazë të nenit 108A të Ligjit për Prokurimin Publik, **kërkesa për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar**, ndërsa **Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues mbetet në fuqi**.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë me lartë ka vendosur si në dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet të dorëzohet brenda afatit ligjor .

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Hajrush J. Shoshi B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Hajrush J. Shoshi B.I.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 531/26 është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar katalog ashtu si është kërkuar në dosje të tenderit dhe oferta e njëjtit duhet të konsiderohet e papërgjegjshme.

AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim sqaron se : *‘Autoriteti Kontraktues konstaton se katalogët e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit janë dorëzuar fizikisht nga Operatori Ekonomik i rekomanduar, ashtu siç është kërkuar në dokumentacionin e tenderit. Gjatë procesit të vlerësimit këta katalogë janë shqyrtuar dhe është konstatuar se specifikimet teknike të ofruara janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Prandaj, pretendimi se katalogët nuk janë dorëzuar nuk është i vërtetë dhe nuk paraqet bazë ligjore për eliminimin e operatorit ekonomik.’.*

Eksperti shqyrtues sqaron se në pajtim me dispozitat ligjore AK mund të kërkoj sqarim apo edhe plotësim të dokumenteve të cilat duket se mungojnë, megjithatë kjo mund të bëhet vetëm në rrethana kur është e mundur që në mënyrë objektive të vërtetohet se dokumenti në fjalë ka ekzistuar para afatit të fundit për ofertim.

PO ashtu ky sqarim/plotësim konsiderojmë se është dashur të bëhet përmes platformës elektronike dhe jo në kopje fizike ashtu siq pretendon AK.

Në rastin konkret vlerësojmë se mungesa e katalogut është dokument i cili mund të plotësohet edhe pas hapjes, por me kusht që OE mund të dëshmojë dhe në mënyrë objektive të vërtetojë katalogu në fjalë ka ekzistuar para afatit të fundit për ofertim.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar, dhe rekomandojmë që me rastin e rivlerësimit AK të vërtetojë nëse katalogu në fjalë ka ekzistuar para afatit të fundit për ofertim ose jo.

Pretendimi nr.2

Për të gjitha pretendimet tjera ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, AK nuk ka ka kthyer përgjigje konkrete duke kundër argumentuar pretendimet e OE ankues, mirëpo AK vetëm është përgjigjur se komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se OE propozuar plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe se nuk ekziston asnjë mangësi që do të ndikonte në përgjegjshmërinë e ofertës.

Një përgjigje e tillë vlerësojmë se nuk është në pajtim me obligimet e AK-së që dalin nga neni 108/A, ku AK është i obliguar që kërkesën për rishqyrtim (në rast të refuzimit) ta trajtoj në bazë të asaj që është kërkuar nga ankuesi.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“Hajrush J. Shoshi B.I.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës”** me numër të prokurimit: **“635-26-2916-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PEJES**

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara dhe rekomandojmë që me rastin e rivlerësimit AK të jap përgjigje konkrete në pretendimet ankimore për secilin pretendim veq e veq duke kundër argumentuar pretendimet e OE ankesë, në të kundërtën (në mungesë të kundër argumenteve) AK duhet të pranoj ankesën si të bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Hajrush J. Shoshi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës**” me numër të prokurimit: “**635-26-2916-5-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PEJES**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Hajrush J. Shoshi B.I.**



Ilir Halili